

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr	Data e Kërkesës ¹	Objekti I Kërkesës ²	Data e Përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
1	03.07.2023	Kërkesë për informacion për bonusin e bebes	04.07.2023	Pershendetje! Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar cekun e bebes, fëmija duhet të jetë i regjistruar në gjendjen civile në Shqipëri. Nuk keni referuar nëse nëna e fëmijës është me leje qëndrimi në Shqipëri dhe a është apo jo e regjistruar në gjendjen civile në Shqipëri, pasi çeku i bebes lëshohet në emër të nënës së fëmijës. Çeku i bebes është kompetencë e Shërbimit Social Shtetëror. Lutemi drejtohuni institucionit të kompetencës . Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
2	03.07.2023	Kërkesë për informacion për certificate trangu familjar	04.07.2023	Përsëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trangu Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit	E plotë	Nuk ka

¹ Data e regjistrimit të kërkesës

² Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

³ Data e kthimit të përgjigjes

⁴ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁵ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁶ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

3	03.07.2023	Kërkesë për informacion për Veçim familje	04.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Vecim Familje", ose ndarje nga Trungu Familjar aplikohet nëpërmjet e-albania-s. Këtë proces e realizoni duke aplikuar ne e-albania shërbimin: "Aplikim per ndryshim/saktesim vendbanimi", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 Dokumentet ligjore të parashikuara për këtë shërbim janë: Kopje e noteruar e certifikatës së pronësisë në emrin Tuaj, Kontrate qeraje e noteruar e banesës ku do jetoni, Akt-Përdorimi noterial banese, Gjithashtu duhet të ngarkoni dhe kartat e identitetit të pjestarëve të tjerë që do veçohen nga trangu familjar sëbashku me ju. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
4	04.07.2023	Kërkesë për informacion për njoftim i ndryshimeve ne rregjistrim	04.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se ndryshimin e gjeneraliteteve, ose çdo ndryshim tjetër në kategorinë biznes, duhet t'i pasqyroj tek sistemi i tatimeve duke aplikuar shërbimin : "Njoftim i ndryshimeve në regjistrim" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13939. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
5	04.07.2023	Kërkesë për informacion zyrtar te pasurise	04.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për te marre informacion mbi ecurine e kerkeses per legalizim, duhet te aplikoni shërbimin: “Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)” përmes platformës qeveritare e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet. Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania. Për të përdorur shërbimin, klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elektronik. Pavarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të sakte kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i	E plotë	Nuk ka

				vendosni 99. Zona kadastrale duhet jete zona qe perfshin parcelen tuaj ndertimore. Per shembull: Nese informacionin zyrtar e kerkoni per qytetin e Tiranes, do perzgjidhni Drejtoria vendore Tirana Veri dhe do vendosni Zone kadastrale 8110, volum 99, faqe 99. Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit. Numri i referencës së aplikimit do ju ndihmojë për të gjurmuar aplikimin. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën, ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit.		
6	04.07.2023	Kërkesë për informacion per maturen shteterore	04.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se aplikimet per maturen shteterore nuk jane hapur ende. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=854 . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
7	04.07.2023	Kërkesë për informacion per VKM shpronesimi apo kompesimi	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pas daljes së VKM-së së shpronësimit apo kompensimit bëhet njoftimi në fletoren zyrtare. Në faqen zyrtare të Agjencisë Trajtimit të pronave gjeni këtë informacion: REGJISTRI I KOMPENSIMIT: Agjencia e Trajtimit të Pronave ne mbështetje dhe ne zbatim te Ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimit te procesit te kompensimit te pronave” ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar te vendimeve përfundimtare qe kane njohur te drejtën e kompensimit për vitet 1993 deri ne 1994. Këto vlerësime u publikuan ne 30 maj ne Regjistrin me rend kronologjik te te gjithë vendimeve qe kane njohur te drejtën e kompensimit. (Kliko këtu) (Agjencia brenda një afati 3 vjeçar do te realizoje vlerësimin financiar te te gjithë vendimeve qe kane njohur te drejtën për kompensim sipas skemës se përcaktuar ne ligj.) Për te gjithë ato subjekte qe kane një vendim te vlerësuar financiarisht lutemi te njiheni me këtë vlerësim dhe te plotësoni mangësitë ne dokumentacion nëse ka. Hapat e procedurës: ► Agjencia njofton publikisht subjektet . ► Subjektet qe disponojnë një vendim përfundimtar te vlerësuar financiarisht kane te drejte te aplikojnë për kompensim. ► Subjektet qe kane nevojte te plotësojnë dokumentacionin kane 6 muaj kohe për ta bere atë. ► Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër	E plotë	Nuk ka

				vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit. Ne zbatim të VKM 223 23.03.2016 'Agjencia e Trajtimit të Pronave njofton subjektet përfituese të paraqiten pranë Agjencisë për tu njohur me vlerësimin dhe për të plotësuar dokumentacion sipas formularit bashkëlidhur, Kompensim Financiar/Fizik. Dokumentacioni që duhet të paraqisni: ► Dokument identifikimi ► Konfirmim nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes. ► Vërtetim nga gjykata kompetente nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore. (Vërtetim që për vendimin Nr. X. Datë x nuk ka ankimim . Ky vërtetim merret në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatën e Rrethit përkatës si dhe Gjykatën Administrative të Apelit) ► Dëshmi trashëgimie, nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtareve ► Prokurorë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm ku si tagër i nevojshëm të jete dhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre. ► Vërtetim për numrin e llogarive bankare ► Vërtetim nëse subjektet (secili prej trashëgimtareve) kanë përfituar apo jo nga dispozitat për ndarjen e tokës bujqësore (Ky vërtetim merret në DAMT/ Këshilli i Qarkut/ Njësia Administrative, në atë vendbanim ku trashëgimtar ka banuar deri në vitin 91) Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
8	04.07.2023	Kërkesë për informacion për vërtetim page	05.07.2023	Përrshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk e disponojmë këtë informacion. Por ju mund të printoni një vërtetim page ose kontributësh dhe atje mund t'i shikoni. Bashkëlidhur gjeni linkun e aplikimit: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908 https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14946 Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
9	04.07.2023	Kërkesë për informacion	05.07.2023	Përrshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk jemi institucioni për të cilin interesoheni. Paraqituni pranë QSHA ose kontaktoni në adresën agim.alia@qsha.gov.al. Për çdo pyetje ose paqartësi, na	E plotë	Nuk ka

		për certifikatë diplome		kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
10	04.07.2023	Kërkesë për informacion për rinovim leje qendrimi	05.07.2023	Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se duhet të kërkonti në e-albania shërbimin, Kërkesë për rinovim të lejes së qëndrimit / Renewal residence permit request, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15309 Shërbimi elektronik "Kërkesë për rinovimin e lejes së qëndrimi" u mundëson shtetasve të huaj, që kanë qëndruar në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të rregullt me leje qendrimi për një periudhë mbi 180 ditë gjatë një viti kalendarik, të bëjnë një kërkesë për të rinovuar lejen e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë. Pas konfirmimit të plotësimit të kushteve dhe dokumentacionit për të aplikuar për rinovimin e leje qëndrimit nëpërmjet këtij shërbimi, i huaji njoftohet nga autoritetet vendor përgjegjëse për kufirin dhe migracionin në territorin ku ai ka vendosur vendbanimin e tij të përkohshëm, për dërgimin nëpërmjet shërbimit postar, të këtyre dokumenteve: - dokumentacioni origjinal; - dy fotografi, në foratin e pasaportës me sfond të bardhë, të bera në 6-mujorin e fundit; - mandat pagesë të tarifës së shërbimit (si dhe të masave administrative (gjobë) të vendosuar për shkelje të afatit të aplikimit për leje qendrimi); - formularit të printuar dhe nënshkruar nga aplikanti me foton e aplikuar në të; Për të aplikuar për rinovimin e lejes së qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, plotësimi i formularit të duhur të aplikimit varet nga motivi i kërkuar i qëndrimit në Shqipëri i cili mund të jetë i njëjtë ose i ndryshëm nga ai i mëparshmi: - Bashkim Familjar me shtetas shqiptar; - Bashkim Familjar me shtetas të huaj të pajisur me leje qëndrimi të vlefshme në Shqipëri; - Studim; - Leje Unike ; - Arsye të tjera; - E Përherëshme; Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
11	04.07.2023	Kërkesë për informacion për legalizim të ndërtimit pa leje	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë kërkesë për legalizim, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14542 Shërbimi elektronik "Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje" u mundëson qytetarëve të aplikojnë online për legalizim dhe pajisje me dokument pronësie për ndërtimet	E plotë	Nuk ka

				pa leje, të ndërtuara pas datës 10.08.1991, për të cilat nuk është aplikuar më parë për legalizim. Dokumentet e nevojshëm janë: Certifikatë familjare, Plan rievimi nga topograf i licensuar, Foto të objektit në të katër pozicionet. Sherbimi i mësipërm aplikohet në rastin kur nuk keni bërë vetdeklarim të ndërtimit pa leje. Në rast se keni bërë vetdeklarim, për të marrë informacion mbi ecurinë e dosjes së legalizimit të objektit Tuaj, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e mëposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477. Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, të cilën do ta ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkon. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
12	05.07.2023	Kërkesë për informacion për vërtetim për pagesë kontributesh	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se dokumenti më i rëndësishëm është librezja e punës, në bazë të së cilës do plotësoni dhe formularin lidhur me vitet dhe qendrat e punës pas vitit 1994. Duhet të aplikoni shërbimin, "Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13888 Hapat e procedures: -Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania - Zgjidhni shërbimin "Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 01.01.1994 deri 31.12.2011" - Klikoni butonin "Përdor" - Plotësoni formularin përkatës dhe dërgoni aplikimin; - Pas procesimit vërtetimin mund ta gjeni në çdo kohë në seksioni "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
13	05.07.2023	Kërkesë për informacion për Autoritetin	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, po ju dërgojmë linkun e faqes zyrtare të Autoriteti Rrugor Shqiptar, ku gjeni dhe kontaktet e institucionit. https://www.arrsh.gov.al/kontaktet Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në	E plotë	Nuk ka

		Rrugor Shqiptar		numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.		
14	05.07.2023	Kërkesë për informacion per DPSHTRR	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Dokumentacioni që duhet për të filluar kursin e teorisë është: Plotësimi i formularit nga DRSHTRR-ja, Kater fotografi me ngjyra, me përmasa 4x5, Karta e identitetit (ose certifikatë personale me fotografi, pasaportë), Certifikata mjekësore që merret në poliklinika e vendbanimit tuaj, Patenta e kategorisë së mëparshme (në qoftë se ke), Mandatpagesa, për cdo dalje në prove të kontrollit të njohurive teorike, sipas tarifave në fuqi. Dokumentacioni që nevojitet për të filluar praktikën: Duhet të kesh fituar testin e teorisë. Kërkesa për të marrë pjesë në provë, sipas modelit të hartuar nga DRSHTRR-ja (këtë zakonisht e kryen autoshkolla ku ju jeni rregjistruar). Mandatpagesa për cdo dalje, në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes. Mandatpagesa për lejen e drejtimit plus taksa e lejes së drejtimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
15	05.07.2023	Kërkesë për informacion për aplikim për rregjistrim fëmije	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fëmijën e lindur jashtë vendit, për shqiptarët rezidentë, mund ta regjistroni nëpërmjet shërbimeve konsullore duke aplikuar nga llogaria e prindit të fëmijës në e-albania shërbimin: Aplikim për regjistrim fëmije, ne linkun e mëposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9767 <i>Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:</i> - Akti i lindjes ose certifikata e lindjes së fëmijës, lëshuar nga autoritetet e huaja (i legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Dokumente identifikimi të prindërve (pasaportë ose kartë identiteti shqiptare) - Përkthimi i aktit ose certifikatës së lindjes, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përkthimin e certifikatës, kërkohet përkthimi në gjuhën shqipe të kryhet në konsullatë, ose nëse është kryer përkthimi nga përkthyes të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë “vërtetim përkthimi”. Tarifa e përkthimit apo vërtetimit të përkthimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Pëlqimi me deklaratë noteriale të prindit të huaj (nëse njëri nga prindërit është shtetas i huaj), për lejimin e regjistrimit të fëmijës në Shqipëri. Nëse nuk do veproni nëpërmjet rrugës së mësipërme po Ju dërgojmë dhe procedurën e regjistrimit të fëmijës	E plotë	Nuk ka

				nëpërmjet të afërmëve si më poshtë vijon: Në pamundësi të paraqitjes së prindërve pranë zyrave të Gjendjes Civile të Njesisë suaj Administrative për të bërë regjistrimin e fëmijës së lindur jashtë shtetit, në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri dhe rrjedhimisht edhe në certifikatën tuaj familjare, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta: Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar. Në vijim prindi, ose personi i autorizuar, pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Për çiftet që nuk kanë martesë zyrtare, fëmija regjistrohet në gjendjen civile ku është e regjistruar nëna e fëmijës dhe rezulton në certifikatë me nënën. Nëse babai i fëmijës nuk është i huaj mjafton karta e identitetit të tij dhe prezenca e nënës së fëmijës me aktin e lindjes në sportelet e gjendjes civile. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
16	03.07.2023	Kërkesë për informacion për pension pleqerie	05.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për te kryer aplikimin për pension pleqerie për persona të vetpunësuar dokumentat që kerkohen janë të njëjta me ato të skemes për personat e punësuar. Bashkelidhur gjeni linkun për kryerjen e aplikimit: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
17	06.07.2023	Kërkesë për informacion për rregjistrim në klasën e dhjetë	06.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin “Regjistrimi në klasë të dhjetë” në linkun e mëposhtëm, https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=10118 Shkolla njofton elektronikisht aplikuesin në rast pranimi ose mospranimi të regjistrimit brenda 5 ditëve nga momenti i dërgimit të aplikimit. Në rast mospranimi, personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, vazhdon aplikimin brenda afatit në institucionin arsimor ku i takon regjistrimi i fëmijës. Për cdo pyetje ose paqartësi,	E plotë	Nuk ka

				na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
18	06.07.2023	Kërkesë për informacion për rezervim tek ALEAT	06.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se do të beni reervimin ne kete linkun : https://rezervo.aleat.al/ dh eme pas do te paraqiteni prane zyrave te ALEAT ne oren dhe daten qe keni rezervuar bashke me kuponin. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
19	06.07.2023	Kërkesë për informacion për celebrim martese	06.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet karta e identitetit per te bere shpalljen e marteses.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.	E plotë	Nuk ka
20	07.07.2023	Kërkesë për informacion për taksë banese	07.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se institucioni kompetent për taksat dhe tarifat vendore është Bashkia. Lutemi drejtohuni faqes zyrtare të Bashkisë ku ndodhet prona Juaj për bazën ligjore. Në faqen zyrtare të Bashkisë do gjeni informacion lidhur me objektet dhe subjektet që përjashtohen nga taksa e ndërtesës. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat: 1. Pronat e shtetit dhe të njëjësive të Bashkisë Tiranë që përdoren për qëllime jofitimprurëse. 2. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me Vendime të Këshillit të Ministrave, në administrimin e shoqërive publike shtetërore. 3. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuara. 4. Banesat sociale në pronësi të Bashkisë Tiranë. 5. Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me Bashkinë Tiranë përdoren nga kjo e fundit si banesa sociale. 6. Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre. 7. Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimeve në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregëtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”. 8. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët. Për efekt të përfitimit nga përjashtimi mbi taksën e ndërtesës, kryefamiljari duhet të ketë mbushur moshën dhe të ketë përfituar pagesën e pensionit. 9. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike. 10. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të	E plotë	Nuk ka

				përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore. Aplikohet një zbritje prej 30% e taksës për tokat bujqësore , për të gjitha sipërfaqet e shfrytëzuara për qëllime bujqësore. Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118 , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
21	07.07.2023	Kërkesë për informacion për regjistrim AMTP	07.07.2023	Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije Fillimisht duhet të aplikoni për të regjistruar aktin e marrjen në përdorim të tokës (AMTP). Ju mund të aplikoni për këtë shërbim online përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9444 Kërkoni shërbimin “ Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ ” dhe aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë dhe duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e shërbimit. Në hapin e dytë shtohen automatikisht edhe këto shërbime: L1- Lëshim certificate pronësie; I5- Lëshim kopje karte të pasurisë; I4- Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale. Dokumentacioni i nevojshëm për t'u ngarkuar është AMTP, certificate familjare në datën 01.08.1991. Plan rievimi. AMTP dhe çdo dokument tjetër që duhet të ngarkohet në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë. Pavarësisht se si i kanë emërtimet dokumentat që duhen ngarkuar në hapin e tretë, do të ngarkoni dokumentat që keni. Aplikimi për regjistrimin e AMTP dhe pajisjes me certificate pronësie nuk penalizohet me gjobë, por kujdes! Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e kryerjes së aplikimit të mësipërm. Në fund klikoni opsionin “ <i>Dërgo</i> ”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Pasi realizoni pagesën, një kopje të mandatit, dhe dokumentet që u kemi cituar më sipër duhet t'i dërgoni me postë pranë ASHK, duke vendosur mbi zarf edhe numrin e referencës së aplikimit. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118 , nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka

22	07.07.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë lindje për shpallje martese	10.07.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se certifikata e lindjes me shënimin " Për shpallje martese" merret pranë sporteve të gjendjes civile. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
23	08.07.2023	Kërkesë për informacion për portalin SMIP	10.07.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë listën e notave të fëmijëve Tuaj, mjafton të kërkoni në google smip.al, të regjistroheni si përdorues i faqes dhe më pas të logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania. Klikoni linkun e mëposhtëm dhe bëni regjistrimin në portal. SMIP . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni me mësuesin kujdestar të fëmijës Tuaj. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
24	08.07.2023	Kërkesë për informacion për regjistrim kontratë shitje	10.07.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se nuk kemi informacion lidhur me çështjen që referoni. Noteri që ka bërë regjistrimin e kontratës së shitjes, duhet t`Ju informojë lidhur me problematikat pas aplikimit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
25	08.07.2023	Kërkesë për informacion për përfitim nga programi i mbrojtjes së vecantë për gratë e papuna	10.07.2023	Përsëritje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi elektronik "Aplikim për përfitim nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç" ju mundëson të gjithë grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje, periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare. Nëse i takoni kësaj kategorie, nga llogaria Juaj në e-albania aplikoni shërbimin, "Aplikim për përfitim nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15191 . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

26	08.07.2023	Kërkesë për informacion për liste notash	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse e keni mbaruar arsimin e mesëm tre deri pesë vitet e fundit, do të paraqiteni pranë shkolles ku keni studjuar për të paraqitur kërkesen për t'u pajisur me listë notash dhe vërtetim mbarimi të shkollës së mesme. Nëse shkollën e keni mbaruar vite më parë, duhet të paraqiteni pranë sporteleve të Postës Shqiptare për të plotësuar formularin e kërkesës për dokumentin e kërkuar. Përgjigjja u vjen po në postën që keni dërguar kërkesën. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
27	08.07.2023	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë ndryshimin e vendbanimit, do të logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktesim Vendbanimi" në linkun e mëposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 . Në aplikim do ngarkoni në format PDF një nga dokumentet e mëposhtme: Kopje të noteruar të certifikates së pronësise, Kontrate noteriale qeraje, Akt noterial perdorimi banese. Fushat që janë me * janë të detyrueshme për t'u plotësuar. Nëse keni vepruar si më sipërcituar, për mosmarrje të shërbimit në afatin ligjor të parashikuar, depozitoni ankesën tuaj në portalin e bashkëqeverisjes duke plotësuar të dhënat në linkun e mëposhtëm. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
28	09.07.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës, merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave ose nënprefekturave të Qarqeve respektive. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
29	10.07.2023	Kërkesë për informacion	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Për aktet e martesave të regjistruara para vitit 2010, do paraqiteni në zyrën e gjëndjes civile të arkivave pranë prefekturës së qarkut Tuaj. Kjo vlen për të	E plotë	Nuk ka

		për certifikatë akti martesor		gjitha qarqet, përjashtuar qarku Tiranë. Për qarkun e Tiranës, procedohet si më poshtë vijon: Për Tirana qytet, do paraqiteni pranë Bashkisë Tiranë për të tërhequr certifikatat. Për fshatrat, do paraqiteni pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë. Përjashtim bëjnë edhe rastet kur martesa është lidhur jashtë kufijve të Shqipërisë. Për këto certifikata, veprohet njëllë si në rastet kur martesa është lidhur para vitit 2010. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
30	10.07.2023	Kërkesë për informacion për kontakt për institucionet	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk disponojmë kontakte të institucioneve. nëse Ju duhen informacione lidhur me shërbimet e gjendjes civile, lutemi na kontaktoni online nga e hëna në të premte, nga ora 08.00 deri në 19.00, në numrin e telefonit pa pagesë 0800 0118 ose ne online chat. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
31	10.07.2023	Kërkesë për informacion për rimbursim të shpenzimeve funerale	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nisur nga mosha, I ndjeri nuk ka qene pensionist. Per rrjedhoje nuk mund te perfitoni rimbursim te shpenzimeve funerale. Thene kjo, pasi ne e-albania merren shpenzimet e funeralit vetem per ata qe kane patur dosje pensioni. Ne kete rast, ju duhet te drejtoheni tek qendra e punes ku ka punuar I ndjeri, duke dorezuar certifikaten e vdekjes dhe faturen e sherbimit funeral. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
32	10.07.2023	Kërkesë për informacion për Rimbursim shpenzimesh për shtetasit shqiptarë që ndërrojnë jetë jashtë vendit	10.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, po ju dergojme kartelen informative me dokumentat qe duhet te dergoni prane Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise per te perfituar rimbursim shpenzimesh per shtetasit shqiptare qe nderrojne jete jashte vendit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
33	11.07.2023	Kërkesë për informacion për licencë	11.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se QKB-ja shqyrton kerkesen dhe merr vendim ne nje afat prej 4 ditesh pune nga data e paraqitjes se kerkeses. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në	E plotë	Nuk ka

		klinike stomatologjike		numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.		
34	11.07.2023	Kërkesë për informacion për certifikatë trungu familjar	11.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikatat e Trungut Familjar nuk mundësohen në e-albania. Për këto certifikata, procedohet si më poshtë: Për qytetaret e Tiranës, certifikatat merren tek Bashkia Tiranë. Për rrethinat e Tiranës merren tek Prefektura Tiranë. Për të gjitha Bashkitë e Komunat e tjera në territorin e Shqipërisë, certifikatat merren pranë Prefekturave të Qarqeve respektive. Për të zhbllokuar llogarinë në e-albania do veproni si më poshtë vijon: Nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk keni aktive asnjë nga të dhënat e regjistrimit(adresë email dhe numër telefoni) për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Hapni një adresë të re email dhe dërgoni këto të dhëna në adresën: helpdesk@e-albania.al :- foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës. Specifikoni adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5(pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllkohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
35	11.07.2023	Kërkesë për informacion për sportelet ADISA	11.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se sportelet ADISA, dhe sportelet fizike të gjithë institucioneve janë mbyllur që në 1 Maj 2022. Për cdo pyetje rreth shërbimeve publike online na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose online chat në faqen zyrtare adisa.gov.al, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
36	11.07.2023	Kërkesë për informacion për perfitim nga programi i strehimit social	11.07.2023	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin " Kërkesë për të përfutur nga programet e strehimit social" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13884 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
